



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs
Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademia za Javnu
Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike/ Saveta Fakulteta Javne Bezbednosti/ Council of the
Faculty of Public Safety

Nr. 3/153

Dt. 30.04.2026

Bazuar në nenin nenit 10 paragrafi 1 të Rregullores (AKSP) Nr. 01/2020-KF për Punën e Këshillit të Fakultetit të Sigurisë Publike, në takimin e K.F. nr. 153 të datës 30 prill 2026, Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike merr këtë:

VENDIM

1. Vazhdohet afati për përfundimin e studimeve (diplomimit) për të gjithë studentët e programeve bachelor të Fakultetit të Sigurisë Publike, të cilët kanë tejkaluar kohëzgjatjen e rregullt të studimeve, por që kanë përfunduar në mënyrë të rregullt ndjekjen e ligjëratave deri në semestrin e fundit të programit studimor.
2. Afati nga pika 1 e këtij vendimi vlen për studentët e regjistruar në sistemin katërvjeçar (240 ECTS kredi), për gjeneratat nga viti akademik 2014/2015 deri në vitin akademik 2020/2021; si dhe studentët e regjistruar në sistemin trevjeçar (180 ECTS kredi), për gjeneratat nga viti akademik 2021/2022 dhe 2022/2023.
3. Studentët nga pika 1 e këtij vendimi obligohen që të përfundojnë të gjitha obligimet e mbetura akademike (provimet, detyrimet tjera dhe mbrojtjen e temës së diplomës) më së largu deri më 30 shtator 2027.
4. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, studentët që nuk i kanë përmbushur obligimet akademike humbin të drejtën për përfundimin e studimeve në kuadër të këtij programi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen menaxhmenti i Fakultetit dhe Shërbimet Studentore.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli.

Arsyetim

Ky vendim është rezultat i një procesi të strukturuar institucional që ka filluar me evidentimin e një numri të konsiderueshëm studentësh të gjeneratave të mëhershme, të cilët nuk kanë arritur t'i përmbushin obligimet e tyre akademike brenda afateve të rregullta të studimeve. Për adresimin e kësaj çështjeje, me vendimin nr. 02/148, datë 08.12.2025, Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike ka themeluar Komisionin për analizimin e situatës së studentëve të gjeneratave 2014/2015 - 2020/2021, me detyrë që të kryejë një analizë të detajuar të gjendjes individuale dhe të përgjithshme të studentëve, si dhe të propozojë masa konkrete për përmbylljen e obligimeve akademike.

Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni ka zhvilluar një proces gjithëpërfshirës që ka përfshirë analizimin e evidencave zyrtare nga Shërbimet Studentore, verifikimin e statusit akademik të secilit student, si dhe komunikim të drejtpërdrejtë me studentët përmes një takimi informues dhe diskutues të mbajtur më 24 prill 2026 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Qëllimi i këtij takimi ka qenë prezantimi i gjendjes aktuale dhe mbledhja e informatave shtesë nga vetë studentët, në funksion të përgatitjes së raportit përfundimtar dhe formulimit të propozimeve për trajtim nga Këshilli në kuadër të diskutimit dhe vendimmarrjes akademike.

Raporti përfundimtar i Komisionit, së bashku me planin e veprimit dhe rekomandimet përkatëse, është shqyrtuar nga Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike, ku është konstatuar se një numër i konsiderueshëm studentësh kanë mbetur me obligime të papërfunduara për shkak të rrethanave të ndryshme, duke përfshirë moskryerjen e provimeve, mos-fillimin ose mos përfundimin e temës së diplomës, si dhe faktorë të tjerë administrativë dhe organizativë të krijuar ndër vite.

Duke u bazuar në këto gjetje dhe në nevojën për të siguruar trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjitha gjeneratat, si dhe për të mundësuar përmbylljen e studimeve për studentët që kanë përfunduar pjesën më të madhe të detyrimeve akademike, Këshilli i Fakultetit vlerëson se dhënia e një afati shtesë të kufizuar kohor është masë e arsyeshme dhe proporcionale. Njëkohësisht, kjo masë kontribuon në rritjen e efikasitetit të sistemit akademik dhe në normalizimin e procesit të studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Sigurisë Publike.

Për këto arsye, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kopja iu dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të FSP-së;
- Publikohet në platformën SMU dhe në ueb-faqen e FSP/AKSP;
- Arkivitet të AKSP/FSP.

Prof. Asoc. Dr. Vilard Bytyqi, u.d. Dekan
Kryesuesi i Këshillit të FSP-së

